

Nr. prot. 746 Tiranë 18 . 06 .2026

Nr. prot. 1249 Tiranë 18.06 .2026

## Marrëveshje Bashkëpunimi

*Ndërmjet:*

**Universitetit Barleti**

*dhe*

**Universitetit të Arteve**

*duke mbajtur parasysh se:*

- *Institucionet e Arsimit të Lartë janë qendra kryesore të kërkimit shkencor kombëtar dhe është detyrë e tyre të përpunojnë e të përçojnë në mënyrë krijuese njohuritë shkencore;*
- *është në interes të IAL-ve të vendosin një raport të qëndrueshëm bashkëpunimi e shkëmbimi akademik, shkencor e kulturor;*
- *palët synojnë shkëmbimin e dijeve dhe rinovimin e njohurive të përbashkëta përmes leksioneve të hapura, seminareve, trajnimit në laborator dhe praktikave;*
- *palët synojnë ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përbashkët bashkëpunimi që do të promovojë specialistë të mirëfilltë.*

*Palët bien dakord për krijimin e një bashkëpunimi afatgjatë dhe të ndërsjelltë midis tyre, për zhvillimin dhe shkëmbimin e eksperiencave të përbashkëta të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe atij artistik.*

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe Objekti**

1. *Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e bashkëpunimit mes institucioneve firmëtare, duke përcaktuar detyrimet e përgjithshme të palëve, drejt realizimit në një moment të dytë të marrëveshjeve specifike lidhur me fushat e bashkëpunimit e shkëmbimit të listuara në pikën 2 të*



këtij neni. Në marrëveshjet specifike do të detajohet lloji i aktiviteteve të përbashkëta, si dhe aspektet financiare midis palëve.

2. Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe mbështetja reciproke midis palëve në fushat si vijon:

- a. Shkëmbim të stafit akademik për procesin mësimor;;
- b. Shkëmbimin e pedagogëve, të kërkuesve shkencorë dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarisë kërkimore-shkencore-artistike;
- c. Praktika mësimore në kuadër të procesit akademik dhe specializime;
- d. Ofrimin e mundësive të punësimit për studentët më të mirë;
- e. Aplikimin e përbashkët në projekte dhe programe të ndryshme bashkëpunimi;
- f. Organizimi i seminareve, konferencave, publikimeve dhe aktivitete të ndryshme shkencore;
- g. Përdorimin e ambienteve respektivisht për praktika, laboratore, seminare, konferenca etj;
- h. Promovimi i palëve në kuadër të aktiviteteve të secilit partner.

## Neni 2

### Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e firmosjes nga përfaqësuesit e të dyja palëve dhe mbetet në fuqi për 4 vjet nga data e firmosjes.
2. Me përfundimin e afatit, nëse asnjëra nga palët nuk shpreh vullnetin për t'i dhënë fund, kjo marrëveshje rinovohet për një afat tjetër 4-vjeçar.
3. Mosrinovimi i kësaj Marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga Universiteti i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

## Neni 3

### Informacion mbi palët

1. *Universiteti BARLETI* (në vijim Barleti), përfaqësuar nga *Prof. Dr. Suzana Guxholli*, Rektor, është një universitet privat, i cili ndër vite ka promovuar një nivel të lartë edukimi, duke synuar të zhvillojë prirjet e çdo studenti, me objektivin e krijimit të ekspertëve më të mirë, të aftë për të konkuruar në tregun ndërkombëtar, me adresë: Rruga Frang Bardhi, Selitë, Tiranë. Misioni i Barletit është krijimi i një institucioni akademik elitare, bazuar në praktikën





e vlerat më të mira ndërkombëtare, më programe shumëdisiplinore të vënë në jetë nga akademikët më të mirë shqiptarë.

2. *Universiteti i Arteve, Tiranë (në vijim UA), përfaqësuar nga Prof. Dr. Erald Bakalli, Rektor, është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, me karakter akademik, artistik dhe shkencor me veprimtari në fushën e arteve, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 234 datë 23.03.2011, i regjistruar me NIPT K51713024L, me adresë: Sheshi "Nënë Tereza", Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë. Misioni parësor i UA është të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, në fushën e artit dhe kulturës si dhe të kontribuojë në zhvillimin artistik, ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal.*

#### **Neni 4**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

##### **1. Universiteti Barleti:**

- a. Barleti, në përputhje me kalendarin e tij të aktiviteteve, angazhohet në ofrimin e ambienteve për trajnime, workshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
- b. Barleti angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve, me marrëveshje specifike, në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje.
- c. Barleti angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut UA, me kërkesën e këtij të fundit, duke vënë në dispozicion stafin e tij;
- d. Barleti shpreh vullnetin për të bashkëpunuar e sjellë rezultate pozitive në drejtim të partneritetit dhe realizimit të objektivave për përmbushjen e misionit dhe vizionit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standartet më të mira në nivel europian;
- e. Personi i kontaktit do të jetë: PhD. Saimir Kristo. Zv. Dekan i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative.

##### **2. Universiteti Arteve:**

- a. UA, bazuar në mundësitë dhe kapacitetet reale institucionale, angazhohet në ofrimin e ambienteve të nevojshme për realizimin e laboratorëve, praktikave dhe specializimin e studentëve të Barletit;



- b. UA angazohet në promovimin e studentëve më të mirë, duke kontribuar në integrimin e tyre në tregun e punës, në përpunime me strategjitë e brendshme të tij;
  - c. UA angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në trajnime, workshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
  - d. UA angazhohet, në bashkëpunim me Barletin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rëndësishme dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje;
  - e. UA angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut Barletit, me kërkesën e këtij të fundit, duke vënë në dispozicion stafin e tij;
  - f. Personi i kontaktit do të jetë: Prof. Asoc. Dorian Çene, Zv. Rektor për Anën Mësimore.
2. *Palët bashkëpunon si vijon:*
- a. të organizojnë takime periodike, të paktën 1 (një) herë në vit;
  - b. të bashkëpunojnë në çdo fushë tjetër të pa listuar më sipër, brenda objektit të tyre dhe për të cilët palët kanë kapacitetet e përshtatshme profesionale.

## Neni 5

### Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve firmëtare, të shprehur vetëm nëpërmjet një dokumenti të shkruar.
  2. Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej partnerëve, çon detyruesisht në prishjen e marrëveshjes. Nëse njëri prej Universiteteve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje, duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë përpara.
  3. Kjo marrëveshje përmban 4 (katër) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale me të njëjtën vlerë ndër të cilat 2 (dy) i mban Barleti dhe 2 (dy) UA.
- Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord:

Universiteti "Barleti"  
Rektori

*Prof. Dr. Suzana Guxholli*

Universiteti i Arteve  
Rektori

*Prof. Dr. Erald Bakalli*